



**SRPSKA LISTA  
SL**

**Raportet Financiare vjetore dhe Raporti i Auditorit të pavarur**

**01 Janar 2019 - 31 Dhjetor 2019**



## **Përmbajtja:**

Raport i auditorit të Pavarur.. .....	3-6
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Informatat e p <sup>o</sup> rgjithshme.....	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10-16



## **Raport i Auditorëve të pavarur Drejtuar Kryesisë së Srpska Lista**

### **Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike**

#### **Mohim i Opinionit**

Ne kemi audituar Pasqyrat financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik **Srpska Lista** (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “SL”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2019, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë dhe informacionet tjetër të paraqitura në tabelat 2 deri 10 të shënimeve shpjegues të përfshira në faqe 9-16.

Ne nuk shprehim opinion mbi raportet financiare të vitit 2019 të subjektit politik “Srpska Lista”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur bazë për një opinion të auditimit.

#### **Baza për Mohim të dhënies së Opinion**

- Subjekti Politik, shënimet e prezantuara në Pasqyra Financiare, nuk mbështeten me dëshmi relevante lidhur me zërat e pasqyrave financiare me 31 Dhjetor 2019 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Pas parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korrigjimet e nevojshme me 31 dhjetor 2019.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 Shpenzimet, të pasqyrave financiare përcjellëse, gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që Subjekti Politik, si qiramarrës, për shpenzimet e qirasë neto në vlerë 30,000.00 € nuk ka mbajtur dhe nuk e ka paguar tatimin në qira në shumë 2,967.00€ sipas obligimit ligjor që buron nga Neni 39 i Ligjit nr. 05/L-028 për “Tatimin në të ardhura personale”
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 Shpenzimet, të pasqyrave financiare përcjellëse, Subjekti politikë ka pas kontratë për shërbimet e konsulentësh me shtetas të huaj ( Sofje, Bullgari) të cilit ju ka kompensuar shërbimi, me një transfer në shume 50,000,00 EURO. Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që subjekti politik nuk e ka mbajtur në burim tatimin e paraparë sipas Ligjit nr. 05/L-028 për “Tatimin në të ardhura personale”. Për më tepër raporti, i punës i paraqitur si rezultat i punës, nuk korrespondon me objektivat dhe detyrat e parapara me kontratën e shërbimit dhe është i pamjaftueshëm për të mbështet transaksionin. Prandaj ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternativë të auditimit të përcaktojmë nëse shpenzimi i deklaruar dhe paguar është i sakte, ka ndodhur dhe i takon aktivitetit të subjektit politik.
- Ashtu siç është shpalosur në shënimin 2 Shpenzimet, të pasqyrave financiare përcjellëse, subjekti politik ka deklaruar në kategorinë e shpenzimeve të ndryshme vlerën 95,405.50 EURO. Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që subjekti politik nuk e ka mbështet me raporte pune, transaksionin në shumë 45.000 EURO me organizatat jo qeveritare si dhe shpenzimi i mjeteve është bere pa ndonjë procedure të tenderimit. Për më tepër, mungojnë raportet dhe dokumentet që dëshmojnë që subjekti politik ka pranuar shërbimin e paguar. Prandaj ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar

procedurat standarde dhe alternative te auditimit te përcaktojmë nëse shpenzimi i deklaruar dhe paguar është i sakte, ka ndodhur dhe i takon aktivitetit te subjektit politik.

- Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe Subjekti politik ne shpenzimet e deklaruar ka përfshirë transaksionet me subjektet te cilat figurojnë si tatimpagues jo-aktiv të Administratës tatimore ne momentin e procedurave audituese, vlera e këtyre shpenzimeve është në shumë 33,997.50 EURO.
- Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe subjekti politik ka nënvlerësuar te hyrat e raportuara pasi qe nuk ka prezantuar te hyrat nga kontributet ne natyre te pranuar nga KK Lepasaviq , shfrytëzimi i një veture sipas Memorandumit të mirëkuptimit nr.08/18 dt.07.03.2018;
- Ashtu siç është shpalosur ne shënimin 2 Shpenzimet, te pasqyrave financiare përcjellëse, Subjekti Politik ka deklaruar shpenzime të karburantit në shumë 6,797.49 EURO. Gjate auditimit ton ne kemi konstatuar qe për shpenzimet e prezantuara subjekti politik nuk posedon evidencë mbi personat, kilometrat e kaluara dhe destinacionet e shfrytëzimit. Prandaj ne nuk ishim ne gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternativë te auditimit te përcaktojmë nëse shpenzimi i deklaruar dhe paguar është i sakte, ka ndodhur dhe i takon aktivitetit te subjektit politik.

### **Theksim i çështjes**

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik e ka definuar, por jo në mënyrë të qartë pasi që mungon një akt i veçantë i këshillit, me nenin 41 “Nadzorni Organ” të Statutit , mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar me qëllim të luftimit të praktikave korruptive dhe ngritjes dhe forcimit të menaxhimit financiar dhe transparencës për të drejtën e anëtarëve për t’u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjektit politik si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne Neni 17 “**Kontrolli i Brendshëm**” të Ligjit Nr.03/L-174 “Për financimin e subjekteve politike” i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-212.
- Subjekti Politik nuk ka shpalosur saktë shënimet mbi pagesat kryera ne vlere mbi 5,000.00€ ( Shënimi Tabela 10) ashtu siç parashihet ne Ligjin nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr:03/L-174 Për financimin e subjekteve politike te ndryshuar dhe te plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 /neni 15 Raportimi financiar.
- Pasqyrat Financiare te SP nuk janë te nënshkruara ne harmoni me : Ligjin Nr. 06/L-032, Për Kontabilitetet, Raportim Financiar dhe Auditimi ; dhe me UA MF-NR. 07/2019 Neni 8 ; Nënshkrimi i pasqyrave financiare ; Pika 2. Nëse drejtori financiar apo zyrtari kryesor financiar nuk është i certifikuar si kontabilist, atëherë pasqyrat i nënshkruan edhe kontabilisti i certifikuar.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**



Drejtesit e Subjektit politik janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të Pasqyrave financiare në përputhje me Ligjit Nr. 03/L-174 “Për financimin e subjekteve politike” i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet Nr.04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-212 dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e Pasqyrave financiare që nuk përmbajnë mosbarazime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e Pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj(parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse drejtimi synon të shuajë Subjektin Politik ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka asnjë mundësi tjetër.

Personat e ngarkuar me qeverisje, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Subjektit Politik.

### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë arritja e një sigurie të arsyeshme nëse Pasqyrat financiare si tërësi janë pa mosbarazime materiale si rezultat i mashtrimit apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e auditimit së bashku me opinionin. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është garanci që një auditim i kryer sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një mosbarazim material kur ai ekziston.

Mosbarazimet mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, në mënyrë të arsyeshme, ndikojnë në vendimet e marra ekonomike të përdoruesve, bazuar në këto Pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, kemi ushtruar gjykimin profesional dhe kemi ruajtur skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:


- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mosbarazimeve materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një mosbarazimi material si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme etj.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Subjektit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, të cilat mund të hedhin dyshime për aftësinë e Subjektit për të vijuar aktivitetet. Nëse arrijmë në përfundimin të ekzistimit të pasigurisë, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e lëshimit të raportit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme të paparashikueshme mund të bëjnë që Subjekti të



ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund ta identifikojmë gjatë auditimit.

Audit&Conto sh.p.k

  
Shaban Muharremi

Auditor ligjor  
6 Tetor 2021



## Pasqyra e Pozitës Financiare

<b>Pasuritë</b>		<b>Me 31 Dhjetor 2019</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>	Shënimi	<b>Shuma në Euro</b>	<b>Shuma në Euro</b>
Toka, objektet dhe pajisjet		-	-
Pasuritë e paprekshme		-	-
Pasuritë tjera afatgjata		-	-
<b>Total pasuritë afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Llogaritë e arkëtueshme		-	-
Parapagimet		-	-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	40,225.66	14,633.84
Pasuritë tjera afatshkurtra		-	-
<b>Total pasuritë afatshkurtra</b>		<b>40,225.66</b>	<b>14,633.84</b>
<b>Total pasuritë</b>		<b>40,225.66</b>	<b>14,633.84</b>
<b>Ekuiteti</b>			
Fondet e akumuluar		14,633.84	-
Suficiti / (deficiti) i vitit		25,591.82	14,633.84
<b>Total Ekuiteti</b>		<b>40,225.66</b>	<b>14,633.84</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Huatë e pagueshme		-	-
Të hyrat e shtyra		-	-
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme dhe të tj.		-	-
Huatë e pagueshme		-	-
Detyrimet tjera afatshkurtra		-	-
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>40,225.66</b>	<b>14,633.84</b>

## Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2019	2018
<b>Të hyrat</b>			
To hyrat nga buxheti		286,387.50	293,887.36
Të hyrat nga anëtarësia		-	-
Donacionet dhe kontributet në të holla		-	-
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime		-	-
Të hyrat e fushatës		-	-
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyra		-	-
Të hyrat tjera		-	-
<b>Gjithsej të hyrat për vitin</b>		<b>286,387.50</b>	<b>293,887.36</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Pagat dhe kompensimet	2	16,993.75	30,896.77
Shpenzimet e transportit	2	7,217.49	23,199.25
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	2	17,299.50	18,700.00
Shpenzimet e fushatës	2	89,383.44	-
Blerja e mallrave	2	4,495.00	7,540.00
Shpenzimet e përgjithshme	2	30,000.00	30,000.00
Shpenzimet e ndryshme	2	95,405.50	617.50
<b>Gjithsej shpenzimet për vitin</b>		<b>260,795.68</b>	<b>279,253.52</b>
<b>Suficiti / (deficiti) për vitin</b>		<b>25,591.82</b>	<b>14,633.84</b>

## 1. Informata të përgjithshme

Subjekti politik : SRPSKA LISTA (Srpska Lista –SL)

Subjekti Politikë: **Srpska Lista**  
Akronimi: SL  
Selija: Mitrovica Veri;  
Web faqja: <http://www.srpskalista.net/>  
NF: ██████████  
E regjistruar: 12.05.2017 numri regjistrues ██████████  
Kryetar : **Goran Rakić**  
Përf.i autorizuar  
financiar: **Darko Radovanovic,**

Pasqyrat financiare te SRPSKA LISTA , janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën BKT.

**Shënimi 2 . Shpenzimet**

<b>Shpenzimet</b>	<b>Shpenzimi në Euro</b>	<b>Pagesa në Euro</b>	<b>Borxhi i mbetur në Euro</b>
<b>Pagat dhe kompensimet</b>			
Pagat dhe kompensimet, neto	14,250.00	14,250.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	-	-	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	1,674.12	1,674.12	0.00
Tatimet në të ardhura personale	1,069.63	1,069.63	0.00
Beneficionet tjera	-	-	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>16,993.75</b>	<b>16,993.75</b>	<b>0.00</b>
<b>Shpenzimet e transportit</b>			
Automjetet motorike të huazuara	-	-	0.00
Karburantet	6,797.49	6,797.49	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksitë etj.	-	-	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	450.00	450.00	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit	-	-	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e transportit</b>	<b>7,217.49</b>	<b>7,217.49</b>	<b>0.00</b>
<b>Reklama, promovimi, reprezentacioni, konferenca</b>			
Lokali	-	-	0.00
Ushqimi	11,349.50	11,349.50	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative	-	-	0.00
Radio dhe spotet televizive	-	-	0.00
Stendat e afishimit dhe reklamimet në gazeta	5,950.00	5,950.00	0.00
Shp. tjera të reklamave, reprezenta. dhe konferencave	-	-	0.00
<b>Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat</b>	<b>17,299.50</b>	<b>17,299.50</b>	<b>0.00</b>
<b>Fushata</b>			
Shpenzimet e fushatës	89,383.44	89,383.44	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e fushatës</b>	<b>89,383.44</b>	<b>89,383.44</b>	<b>0.00</b>
<b>Blerja e mallrave</b>			

**Srpska Lista**

*Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor, 2019*

Furnizimi i zyrës	4,495.00	4,495.00	0.00
Pajisjet të vogla	-	-	0.00
<b>Gjithsej blerja e mallrave</b>	<b>4,495.00</b>	<b>4,495.00</b>	<b>0.00</b>
Qiraja e lokalit të zyrës	30,000.00	30,000.00	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	-	-	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	-	-	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	-	-	0.00
Shp. lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime	-	-	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>0.00</b>
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	100.00	100.00	
Shp.që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	95,306.50	95,306.50	0.00
<b>Gjithsej shpenzimet e ndryshme</b>	<b>95,406.50</b>	<b>95,406.50</b>	<b>0.00</b>
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>260,795.68</b>	<b>260,795.68</b>	<b>0.00</b>

**Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

Pranuar nga				Vlera	E pranuar përmes:	
Kontribuesi	Adresa	Numri personal	Data kur është dhënë kontributi	në euro	Bankë	Arkë
<b>Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla</b>				-	-	-

**Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime**

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera
	Kontribuesi	Adresa	Numri personal		në euro
<b>Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime</b>					-

**Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fund të vitit (vlera neto)
Toka					
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
<b>Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet</b>					

**Shenime tjera**

<b>Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
<b>Gjithsej Llogarit e arkëtueshme</b>		

<b>Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Paraja në bankë	40,225.66	14,633.84
Paraja në arkë	-	-
<b>Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë</b>	<b>40,225.66</b>	<b>14,633.84</b>

**Srpska Lista***Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor, 2019*

<b>Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Furnitori 1 - regjistri		
Furnitori 1		
Furnitori 1		
<b>Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera</b>		

<b>Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2019 Shuma në Euro</b>	<b>Me 31 Dhjetor 2018 Shuma në Euro</b>
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime		
Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet)		
<b>Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra</b>		

**Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 €**

Qëllimi i pagesës	Pagar ndaj:				Data e pagesës	Vlera në euro
	Personi Fizik/Juridik	Adresa	Nr./NUI			
Zakup poslovnog prostora	Rados Petrovic	Anke Spajic 70, Mi			11.04.2019	30.000.00
Maice,Kacketi sa stampom	PP Eliot-Dusanka Vasic	Prote Stojana 24, Zv			05.06.2019	4.940.00
Troskovi reprezentacije	-/-	-/-	-/-		06.06.2019	4.976.00
Troskovi reprezentacije	-/-	-/-	-/-		10.06.2019	4.900.00
Troskovi reprezentacije	-/-	-/-	-/-		08.07.2019	2,980.00
Statisticko istraziv.u Srps.zajedn.	Digital Media Association	Prote Stojana 24, Zv			30.07.2019	45.000.00
Konsultantske usluge	Zoltan Mihok	Sofia, Bulgaria	N/A		15.08.2019	50.000.00
Plakati A1, posteri B1	Ljubisav Arsic IB	Kolasinska S 1/37, Mi			18.09.2019	4.625.00
Lepak za postere, bilborde	-/-	-/-	-/-		20.09.2019	1.650.00
Usluge marketinga	-/-	-/-	-/-		27.09.2019	3.040.00
Troskovi reprezentacije	-/-	-/-	-/-		01.11.2019	2,795.00
Hem.olovke, upaljaci sa stampom	Jovana Ajdukovic IB	Cika Jovina 3/2, Mi			18.09.2019	4.900.00
Majice, kacketi sa stampom	-/-	-/-	-/-		20.09.2019	3.460.00
Bilbordi	-/-	-/-	-/-		24.09.2019	4.200.00
Oglasavanje u medijima	-/-	-/-	-/-		27.09.2019	1.125.00
Kancelarijski material	-/-	-/-	-/-		01.11.2019	2,795.00
Hrana i pice, ozvucenje, salla	Elegance Prime	Rudarske Cete Mi			07.11.2019	4,987.50
Nedostaje racun	-/-	-/-	-/-		24.12.2019	735.00
Bedzevi	TIM-D Darko Vasiq	Karadjordjeva 34, Zv			06.06.2019	2,100.00
Reklama na TV	-/-	-/-	-/-		10.06.2019	2,700.00
Kancelarijski material	-/-	-/-	-/-		19.06.2019	1,700.00

Srpska Lista

Shënimet për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor, 2019

Ogasvanje u medijima	-/-	-/-			08.07.2019	2,970.00
<b>Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro</b>						
						<b>186,548.50</b>